



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT

Nr 7466 Prot

Gjirokastrë më 24 .08 :2023

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31. 07. 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.07. 2023

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **datë 31.07.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë UGJ. Mbledhja fillon në orën 12:00

Marrin pjesë në mbledhje: Mimoza Çabeli, Eri Shehaj, Spartak Drasa, Eleva Kondi dhe Armand Hilaj.

Hapet mbledhja nga Znj Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj Isaraj paraqet rendin e ditës.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 03.07.2023.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.07. 2023**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.07. 2023**”.
4. P/ vendim “Për miratimin e shtyjes së afatit për subvencionin e interesit të kreditës financuar nga fondet e buxhetit të bashkisë Gjirokastrë për z. Lirjo Seferi për një periudhë 6 mujore”.
5. P/Vendim “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2024-2026”.
6. P/Vendim “Për shtesa dhe pakësime në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023”.
7. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr.98, datë 16.12.2022 “Për miratimin e nr maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave në bashkinë Gjirokastrë për vitin 2023”.
8. Për emërimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak.
9. Të ndryshme.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi i ditës me 22 vota pro.

Hidhet në votë dhe miratohet procesverbali i mbledhjes sw datws 03.07.2023 me 23 vota pro.
Vijnë në mbledhje Z. Çuçani,Znj. Leskaj, Z. Qeli.

Z. Aliko kërkon fjalën dhe shprehet se kërkon nga ekzekutivi informacion mbi buxhetin zë më zë sipas drejtorive përkatëse . Sa % e buxhetit është harxhuar? Sa ka genë fondi rezervë?Një rezyrme për të gjithë buxhetin. Kartonat I keni , por ne si këshilltarë të rinj duam më tepër informacion.

Z. Golemi: Jemi për transparencë për vitet që nga 2019 e në vazhdim , por edhe për situatën ku e gjetëm. Të ftoj të lexosh fagen 115 të PBA –së.Por në mbledhjen e ardhshme të vijë informacioni për këshilltarët sa janë planifikuar, sa janë realizuar dhe me detajime specifike.

Znj. Isaraj lexon emrat e kryetarëve të komisioneve dhe i kërkon Komisionit të Shërbimeve Publike të mbledhet pas mbledhjes për zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit.

Hidhen në votë dhe miratohen me 24 vota pro dy pikat e ndihmës ekonomike. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushhtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.07. 2023**”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.07. 2023**”.

Pika 4 e rendit të ditës hidhet në votë dhe miratohet me 24 vota pro. P/ vendim “Për miratimin e shtyrjes së afatit për subvencionin e interesit të kredisë financuar nga fondet e buxhetit të bashkisë Gjirokastër për z.Lirjo Seferi për një periudhë 6 mujore”.

Në lidhje me pikat 4,5, 6 të rendit të ditës shprehet Manjola Shehaji:Në zbatim të ligjit për buxhetin Bashkia ka hartuar dokumentin e pare të programit buxhetor afatmesem 2024-2026 sipasi nstrumentit të planifikimit financiar për bashkitë pilot.Planifikimi financiar është realizuar mbi 7 programe dhe 24 funksione. Programet janë si më poshtë;

1. Aparati dhe Menaxhimi I bashkisë.
 2. Shërbimi social dhes hëndetësor
 3. Turizmi trashëgimia, arti, kultura dhe sportet
 4. Siguria publike
 5. Shërbimet publike komunitare dhe utilitare
 6. Mbështetje për rarsimin
 7. Zhvillimi ekonomik ,bujqësisë dhe pylltarisë
- Referuar të dhënave sipas dokumentit PBA 2024-2026 rezulton se: Planifikimi I të ardhura VE të veta është bërë Brenda një kuadri rritjeje 2% derinë 3% për çdo vit nga 2024 deri në 2026 duke mbajtur si bazë vlerësimi të ardhurat e planifikuara për vitin 2023.
- Shpenzimet në vite luhaten në përputhje me tendencën në rritje të të ardhurave në total.Shpenzimet kapitale parashikohen të realizohen në programet e menaxhimit të bashkisë për hartimin e projekteve të investimeve, në programin e shërbimit social, nëprogramin e turizmit dhe trashëgimisë, në programin e sigurisë publike, në programin e shërbimeve publike dhe atë të mbështetjes në arsim.Buxheti afatmesëm paraqitet në vlerën 720 186 000 lekë për vitin 2024, në vlerën 741 228 000 lekë për vitin 2025, në vlerën 762 685 000 lekë për vitin 2026.

Z.Golemi: Bashkia Gjirokastër është një nga 3 bashkitë pilot në hartimin dhe zbatimin e PBA-së. Ministria e Financave sjell rekomandimet të cilat zbatohen në planifikimin e PBA.

Z.Brahimi: Aka një planifikim bashkia për vitin 2024 për trajtimin e ujërave të zeza dhe për landfill për mbetjet?

Z.Golemi: Është planifikuar ndërhyrje dhe bashkia Gjirokastër është pjesë e projektit për trajtimin e ujërave të zeza, I cili do jetë një projekt afatgjatë që përfshin të gjitha bashkitë që prek luginë e Vjosës, por përse I përket landfillit bashkia jonë ka si pikë fundore landfillin në Bajkaj, kurse si pikë transit kemi pikën e Grihotit ku të gjithë jemi dëshmitarë të punës që është bërë .

Z. Aliko: Ne sot flasim për shifra që nuk ia dimë burimin. Ne në parim kemi folur për çdo problem edhe në këshillat e mëparshëm, siç janë problem i tregut , kemi kërkuar sepse kemi interesat e qytetarëve, dhe na vjen keq për mënyrën si është katandisur qyteti.

Z. Golemi: Këshilli Bashkiak është përgjegjës për çdo vendimmarrje, mund të flasim për ato edhe para 2019, për tregun apo për futbollin për të cilat nuk kemi lënë gur pa lëvizur.

Po flasim për një trend tjetër zhvillimi të qytetit ku numri turistëve po arrin në 250 mijë që nuk vizitojnë vetëm qytetin ,por edhe njësitë administrative dhe nga të ardhurat e veta bashkia ka siguruar 210 milion lekë për 2022 dhe parashikohen rreth 240 milion për 2023 dhe përkthehen në investime publike e shërbime më të mira për qytetarët.

Znj.Artiste Koko; PBA 2024-2026 planifikohet në zbatim të ligjit të buxhetit ku zbatohen dy procedura të ndara nga njëra tjetra. Që në dhjetor të vitit paraardhës miratohet kalendari I hartimit të PBA-së .Në janar realizohet analiza e zbatimit të buxhetit, në mars në këshill sjellim tavanet buxhetore , për periudhën mars- maj raportojmë në MF dhe në 1 qershor e paraqesim dokumentin para MF dhe rekomandimet I zbatojmë në dokumentin e paraqitur para jush.

Përse i përket shifrave kemi të ardhurat e veta 199 milion në 2021 , 228 milion në 2022 dhe 230 milion në 2023.

E trashëguara nuk parashikohet por bëhet pjesë e buxhetit të vitit pasardhës me fokus projektet dhe investimet e përfunduara.

Në fund të dhjetorit përfituam fondin 100 milion për Pallatin e Sportit dhe 11.810.000 për 5% e llogarive të ish-komunave e cila futet te të ardhurat e veta sepse është krijuar nga puna e bashkisë për ta fituar këtë shumë. Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro dhe 3 abstenime pika 5 e rendit të ditës P/Vendim “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2024-2026”.

ZNJ. Isaraj : Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës:

Z. Brahimi: Sygjerohet të kontrollohet punimet sepse po punohet keq.

Z. Golemi: Është hapur prokurimi për Pallatin e Sportit në vlerë 100.000.000. Në zbatim të procedurës së prokurimit është shpallur firma mituese me 69.000.000 lekë

Lekët e mbetura do të përdoren përsëri për sportin, për investime te Fusha e Vjetër, te gjimnazi “Siri Shaplllo”

Z. Aliko: Po sikur më vonë firma të kërkojë dhe 25% të vlerës për të përfunduar punimet, sepse kemi qenë para fakteve të tilla? A e ka menduar bashkia këtë gjë sepse gjendemi para fakteve sit e gjimnazi “ AsimZeneli”?

Të jenë specialistët pjesë e marrjes në dorëzim të punimeve.

Z. Golemi: Nuk kemi parashikuar lekë të tjera për firmën se firma është futur conform ligjit, por sigurisht që do të jemi të kujdesshëm për punimet dhe marrjen në dorëzim të tyre.

Miratohet me 25 vota pro P/Vendim "Për shtesa dhe pakësime në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 "Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023".

Pika 7 e rendit të ditës:

P/Vendim "Për një ndryshim në VKB Nr.98, datë 16.12.2022 "Për miratimin e nr maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave në bashkinë Gjirokastër për vitin 2023"

Hidhet në votë dhe miratohet me 25 vota pro.

Kalohet te pika 8 e rendit të ditës. Znj Isaraj paraqet propozimin për znj. Etleva Yzo për t'u zgjedhur sekretare e Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votë dhe miratohet me 25 vota pro P/Vendimi "Për emërimin e Znj.Etleva Yzo sekretarit të Këshillit Bashkiak Gjirokastër".

Në fund të mbledhjes kërkohet nga ekzekutivi të sjellë informacion për fondin e pagave, investimet , buxhetin e detajuar dhe shërbimet e deleguara.

Nga z. Qeli kërkohet informacion për shërbimin urban, kurse nga znj Shehaj informacion për banjat publike të qytetit.

Mbyllet mbledhja nga znj Isaraj në orën 13:05.

Sekretar

Etleva Yzo

